

## **STUDIME DHE ARTIKUJ**

Anton Berisha

### **PËRKIME POETIKE TË POEZISË GOJORE DHE TË KRIJIMTARISË SË LASGUSH PORADECIT**

Problemi i ndikimeve, i gërshetimeve dhe i përkimeve poetike të poezisë gojore shqipe dhe poezisë së shkruar që krijohet prej Lidhjes së Prizrenit deri në Luftën e Dytë Botërore,<sup>1</sup> jo vetëm është i pranishëm dhe shprehet në vëllim dhe mënyra të ndryshme, por është njëri ndër më të rëndësishmit për studimin dhe përcaktimin e disa tipareve dhe esencave, para se gjithash të poezisë së shkruar të kësaj periudhe. Brenda kësaj problematike shqyrtimi i përkimeve poetike të poezisë sonë gojore dhe poezisë së Lasgush Poradecit, njërit ndër lirikët më të mëdhenj shqiptarë, lidhet drejtpërdrejt me disa nga cilësitë kryesore të prodhimit letrar të këtij poeti, por edhe në përgjithësi me lirikën e shkruar shqipe të periudhës së përmendur. Edhe pse lirika e Poradecit esencialisht është poezi moderne dhe artistikisht e një niveli të lartë, shpesh tematikisht e ndryshme në krahasim me atë gojore, ajo ka si mbështetje të fortë lirikën gojore shqipe, jo vetëm një pjesë e poezisë së Poradecit, sikur është menduar e theksuar shpesh, por gjithë prodhimtaria e tij poetike.

#### **Esencë e kompleksitet**

Shqyrtimi i fenomenit të përkimeve poetike të poezisë gojore shqipe dhe lirikës së Poradecit është sa i rëndësishëm, po aq dhe i ndërliqshëm. Kjo gjë lidhet me faktin se të flasësh për këtë poezi domethënë të bësh fjalë për disa nga problemet dhe elementet më esenciale të poezisë së shkruar moderne shqipe, të merresh me fenomene më të ndërlikuara të artit të fjalës, me veprën, të ashtuquajtur, e hapur, e cila cilësohet jo vetëm me konceptonin vetijak ori-

<sup>1</sup> Ky punim është pjesë e projektit *Përkime poetike të letërsisë gojore shqipe dhe letërsisë së shkruar prej Lidhjes së Prizrenit deri në Luftën e Dytë Botërore*, përkatësisht pjesë e kreut të katërt — *Përkime poetike në poezi*.

gjinal poetik, por edhe me shtresa të shumta artistike dhe kuptimore. Mirëpo në qoftë se ky sistem i veçantë i të shprehurit artistik vështrohet në kuadrin e fenomenit të përkimeve poetike, pranisë e të ndikimit të poezisë gojore, të ndryshimeve e të transformimit të së dytës në krahasim me të parën, atëherë çështja sa shkon e bëhet më komplekse, sepse krahas theksimit të specifikave të ndjeshmërisë lirike të poezisë së këtij krijuesi dhe të poezisë lirike gojore, duhet veçuar e theksuar edhe ato tipare që janë të përbashkëta brenda shprehjes lirike dhe transponimit lirik të fenomeneve e të botës subjektive të njeriut etj.

Cilat janë disa nga cilësitë e poezisë së Lasgush Poradecit dhe disa nga shkaqet kryesore të shqyrtimit të saj nga aspekti i përkimeve poetike?

Për t'i vënë në pah disa nga cilësitë e kësaj poezie po përmendim mendimin e prof. Eqrem Çabejt shfaqur (qysh më 1929) në punimin „Mbi poezinë e Lasgush Poradecit”:

„Ç'e ndryshon nga të parët (Lasgush Poradecin si poet — v. ime) është thellësia ... Është vjershëtori më i thellë që ka shkruar në shqipet: në qoftë se kjo nuk është vënë re gjer tani, shkak është se më të shumë nuk e kuptojnë poezinë e tij, e cila me fjalë e mënyra foljesh fare të thjeshta, e shumë herë popullore, arrin të koncentrohet aq sa mundet të nxjerrë në dritë mendimet më të thella, ndjenjat më labirintike, idetë më të larta. Dhe po të këndohej Lasgushi me dashurinë, do të vërtetohet thellësia e tija e pashoqe, në mos sot, nga brezat që do të vijnë”.<sup>2</sup>

Duke bërë fjalë mëtej për këtë poezi Çabej thekson: „Po moskuptimi i lehtë, të themi errësira e disa vjershave të tija, nuk është një e metë, përkundrazi një element i gjithë shkrimeve të thella në botë që prej poemave indiane e, nëpër Kuranin, gjer më sot. Fundi i fundit çdo thellësi është e errët”.<sup>3</sup>

Në mënyrë të veçantë Çabej ka hetuar dhe ka theksuar rëndësinë dhe funksionalitetin e gjuhës dhe të shprehjeve gjuhësore, prandaj me të drejtë thotë: „Kush nuk mundet nga magjia e kësaj gjuhe? Djalëri shqiptare, këndo Lasgush Poradecin, e pastaj vdis!”<sup>4</sup>

Mendimi tjetër i rëndësishëm, nga i cili dalin edhe disa cilësi të poezisë së L. Poradecit, është ai i Mitrush Kutelit, shfaqur në parathënien e botimit të dytë të poezive të Lasgush Poradecit *Ylli i zemrës* (Bukuresht 1937). Ky studiues, njëri ndër njohësit më të mirë të poezisë së Poradecit, duke e çmuar lart këtë poezi, thekson:

„... kjo i detyrohet (vështrimi i zgjeruar i poezisë së L. Poradecit — v. ime) vetëm e vetëm artit-mjeshtër të veprës lasgushiane e cila prej shumë vitesh e ka robëruar me bukuritë e saj pa shoqe në literaturën shqipe e me shoqe të rralla në letraturën e përbotshme.

<sup>2</sup> Eqrem Çabej, *Mbi poezinë e Lasgush Poradecit*, në: Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, *Kritika letrare, Tekste, Shënime, Komente*, Rilindja, Prishtinë 1979, f. 272.

<sup>3</sup> *Po aty*, f. 276.

<sup>4</sup> *Po aty*, f. 276.

Përfundimi i tij (i studiuesit — v. ime) në mbarimin e këtij vëzhgimi kritik është se Lasgushi shfaqet e mbetet një kulm vigan i cili ka për të zotëruar shumë kohë me hijen e vet letraturën dhe mendimin shqipëtar<sup>5</sup> dhe „... Lasgushi është poet shqiptar, i vetëmi poet shqiptar, që mendon, flet e shkruan vetëm shqip”.<sup>6</sup>

Me qëllim i theksuam këto mendime, sepse edhe fenomeni i përkimeve do të shqyrtohet brenda aspekteve që u përmendën, gjë që do të bëjë të mundur t'i shmangemi qasjes dhe interpretimit pozitivist të kësaj poezie, sikur ka ndodhur shpesh, dhe bashkë me këtë çështjen e përkimeve poetike, të gërshetimeve, të pranisë e të ndikimit të mundshëm ta vendosim në një bazë më të sigurt dhe më të qëndrueshme. Përndryshe, mendimet rreth poezisë së këtij poeti janë të ndryshme, herë-herë dhe kontradiktore.<sup>7</sup> Në të vërtetë atij i është bërë vërejtje, para se gjithash, për paqartësinë e poezisë së tij, është quajtur idealist dhe mistik, poeti i „l'art pour l'art"-tit dhe përfaqësues i poezisë filozofike të paqartë.<sup>8</sup>

Më vonë kësaj poezie iu bënë shumë qasje dhe interpretime të rëndësishme adekuate. Në këtë mes po veçojmë parathënien e Sabri Hamitit në vëllimin *Vdekja e Nositit* (Prishtinë 1978), deri më tash botimi më komplet i poezisë së këtij lirikut të madh.<sup>9</sup> Po ashtu punimet e botuara në revistën „Fjala” (Prishtinë, viti XII, nr. 22, 15 dhjetor 1979 — me rastin e 80-vjetorit të lindjes së poetit) paraqesin një vështrim e interpretim të thelluar dhe adekuat të kësaj poezie, përkatësisht një qasje e interpretim modern të cilësive kryesore të kësaj poezie nga disa aspekte e nga disa rrafshe.<sup>10</sup> Në këto punime u konkretizuan shumë mendime të thëna më parë për vlerat e jashtëzakonshme të poezisë së këtij krijuesi, përkatësisht të kësaj lirike moderne në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

Vlerat, moderniteti dhe aktualiteti i kësaj poezie qëndrojnë, para së gjithash, siç vë në dukje në mënyrë të përmbledhtë I. Rugova, në planin konceptual dhe poetik,<sup>11</sup> pra nga aspekti i gjuhës poetike dhe i strukturës së tekstit dhe i mesazhit artistik, qoftë kur çështja vështrohet në njësitë si strofa, vargu apo njësitë më të vo-

<sup>5</sup> Mitrush Kuteli, *Fjala e editorit*, në: *Kritika letrare*, Prishtinë 1979, f. 385.

<sup>6</sup> *Po aty*, f. 350.

<sup>7</sup> Krist Maloki, *A asht poet Lasgush Poradeci*, në: *Kritika letrare*, e cit. f. 228.

<sup>8</sup> Dh. Shuteriqi, *Historia e letërsisë shqipe*, Doracak për shkollat e mesme, botimi i gjashtë. ETMM, Prishtinë, 1879, f. 264. Skender Luarasi, *Letërsia moderne në Shqipëri*, në: *Kritika letrare*, e cit. f. 327.

<sup>9</sup> Lasgush Poradeci, *Vdekja e Nositit*, zgjedhi e përgatiti për shtyp Sabri Hamiti, Rilindja, Prishtinë 1979, Parathënia e S. Hamitit, f. 7—46.

<sup>10</sup> Revista *Fjala*, Viti XII, nr. 22, 15 dhjetor 1979, sidomos punimet e Mensur Raifit, Ibrahim Rugovës, Sabri Hamitit, Rexhep Ismajlit etj.

<sup>11</sup> Ibrahim Rugova, *Nevojë imanente e poezisë shqipe*, në: *Fjala*, e cit. f. 6.

gla, qoftë në poezinë si tërësi.<sup>12</sup> (Pse duhej të kalonin më së katër dhjetëvjetsha për ta prezentuar dhe për ta interpretuar në mënyrë adekuate këtë poezi, është çështje që i kalon coqet e temës sonë.)

Nëse vlerësimi dhe interpretimi i berë adekuat i poezisë së L. Poradecit, si sistem i veçantë kuptimor dhe poetik, i afrohet vlerës reale të saj, atëherë rreth problemit të përkimeve poetike është bërë më pak punë, jo nga aspekti i sasisë, por i cilësisë, pra i shqyrtimit sa më kompleks të tij në gjithë poezinë e Poradecit. Me këtë nuk mohohet fakti se disa autorë kanë vërejtur me të drejtë fenomenin e përkimeve të poezisë së këtij autori me poezinë tonë gojore, por atë e kanë shqyrtuar vetëm duke pasur parasush një numër të caktuar poezish,<sup>13</sup> të cilat me poezinë gojore përkojnë pos të tjerash edhe nga aspekti tematik dhe motivor.

Brenda shqyrtimit të përkimeve poetike të poezisë gojore dhe krijimtarisë së këtij poeti fenomeni është parë pra më tepër nga aspekti tematik e motivor dhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, që zakonisht i cilëson punimet dhe qasjet pozitiviste të shqyrtimit të fenomeneve të këtilla. Kështu edhe punimet e Ali Jasiqit e të Myzafer Xhaxhiut<sup>14</sup> në esencë nuk shkojnë më larg se ajo që është thënë parimisht edhe në punimet e mëparshme, që nuk e kanë shtruar në mënyrë të veçantë këtë problem. Në këto punime dhe në disa mendime të rastit në punime të ndryshme, krejt pak bëhet fjalë për gjuhën poetike, për përkimet e mesazhit artistik të poezisë lirike gojore dhe lirikës së Poradecit. Pra, janë lënë anash të gjitha ato elemente esenciale të strukturës së tekstit poetik dhe të ritmit e frymës së përgjithshme të lirikës si refleksion dhe ndjeshmëri e botës subjektive të krijuesit, të cilat madje meritojnë kujdesin më të madh kur vështrohet fenomeni i tillë.

### Tradita dhe moderniteti

Para se të bëjmë fjalë për problemin e gërshetimeve dhe të përkimeve të strukturës gjuhësore poetike, përkatësisht të gjulës magjike të lirikës së Poradecit, sikurse e ka quajtur Çabej, dhe për faktin se pse Poradeci është poet që mendon, flet dhe shkruan vetëm shqip, sikurse ka theksuar M. Kuteli, po shqyrtojmë më për afër çështjen e traditës dhe të modernitetit, për të hetuar më qartë fenomenin e interferencës poetike të këtyre dy sistemeve letrare — poezisë lirike gojore dhe lirikës së Lasgush Poradecit.

Si poet Poradeci u formua në kohën kur në traditën poetike shqiptare „forma quhej formalitet, metrika prozodi dhe silabizmë,

<sup>12</sup> Mensur Raifi, *Koncepcioni i poetit mbi poezinë*, në: Fjala, e cit. f. 1 dhe 3.

<sup>13</sup> Shih, Mitrush Kuteli, *pun. cit.* f. 343, 345—346. cit. f. 417.

<sup>14</sup> Ali D. Jasiqi, *Pesha e fjalës*, Rilindja, Prishtinë 1971, f. 222—242; Myzafer Xhaxhiu, *Disa shënime rreth veprës poetike të Lasgush Poradecit*, në: *Vezhgime letrare*, redaktuar nga Anton Pashku, Prishtinë 1978, f. 163—175.

dhe retorika emfazë gojëtarije që s'kanë asnjë të përpjekur me esencën... të poezisë lirike të vërtetë".<sup>15</sup> Duke e pasur parasysh një qëndrim të tillë dhe duke qenë i vetëdijshëm për nevojën e transformimit, përkatësisht të ndërrimit të një konceptioni të tillë ndaj poezisë dhe artit letrar në përgjithësi. Poradeci arriti të sublimojë atë që ishte krijuar deri atëherë dhe t'i hapë një horizont të gjere poezisë moderne shqipe. Ai ishte i vetëdijshëm se *diferentia specifica* e poezisë qëndron në formën që krijohet nëpërmjet gjuhës poetike, raportit që krijonë fjalët, fuqisë shprehëse dhe kuptimore të tyre, ritmit dhe ritmikës etj. Këto specifika Poradeci pati mundësi t'i hetojë dhe t'i shijojë edhe në poezinë e shkruar edhe në poezinë gojore. Mirëpo ai kishte krijuar vetëdijen poetike të lartë, ishte bindur në mundësinë e pakufishme të shprehimësisë dhe të kuptimësisë së fjalës poetike, në mundësinë e kombinimit të tyre dhe në fuqinë magjike që do të krijonin ato kur gjenden në një raport specifik, reciprokisht të lidhura e determinuese nga shumë aspekte.

Dy janë faktorët që kanë ndikuar në gërshetimin dhe përkimin e poezisë së tij me poezinë gojore shqipe.

I pari lidhet, sikur ngjet edhe te përfaqësuesit e tjerë, me kontaktin e drejtpërdrejtë të këtij poeti me krijimtarinë e pasur letrare gojore, të cilën Poradeci e përjetoi dhe e shijoi në mënyrë kontinuitive në vendlindje, por edhe nëpërmjet botimeve të ndryshme, që në kohën e formimit të tij si poet ishin më të shpeshta e më cilësore. Sidomos duhet theksuar vlerat dhe tiparet e lirikës gojore të qytetit të Poradecit dhe të rrethinës, e cila veçohet me një gjuhë poetike të pasur, me ritëm e ritmikë e para së gjithash me një lirizëm të shquar, që shprehet nëpërmjet një strukture specifike të mesazhit poetik, forcës dhe thellësisë së ndjenjave lirike, pra një bote thellësisht intime, lirikë me ritëm e efekte tonike të shumënduarshme, një sistem i ngritur i shprehimësisë poetike, që është i zoti të bëjë ndikim të shumëfishtë në marrësin dhe në estetikën receptive të tij.

Elementi i dytë lidhet me dijen dhe përvojën që fitoi Poradeci gjatë shkollimit të tij në Rumani, në Austri dhe në vende të tjera, me ç'rast ai u njoh me të arriturat më të mira të letërsive që avansonin brenda modernitetit letrar, sidomos në poezi.

Në gërshetimin e këtyre dy faktorëve Poradeci formohet si një personalitet i fortë poetik, i cili mund ta kuptojë në esencë poezinë si art i fjalës dhe mundësinë e saj të jashtëzakonshme shprehëse dhe ndikuese.

Këtë gjë mund ta vërejmë edhe po që se ua hedhin një sy shkrimeve të pakta kritike që i botoi ky poet, e sidomos nëse thellohem në procesin e krijimit të vetë poezisë së tij, ku punoi me përkushtim të madh në krijimin e secilës poezi (duke shkruar në variante) derisa bindej se ajo ka marrë formën më adekuate, nga e

<sup>15</sup> M. Raifi, *pun. cit.* f. 3.

cila do të dalin dhe kuptimësitë dhe vlerat artistike më të thella e të qëndrueshme, pra do të bëhet efekti më i madh i ndikimit estetik, të cilin Poradeci e vë në dukje në shumë raste.

Te vepra letrare Poradeci vlerëson para së gjithash vlerën artistike, përkatësisht strukturën e mesazhit artistik, e cila del prej strukturës së tekstit të krijimit. Vepra letrare është tërësi unike dhe çdo kritik që synon ta shqyrtojë atë në mënyrë parciale, vetëm jep një gjykim që s'do ta shprehë intencën dhe punën krijuese të autorit. Në këtë kontekst Poradeci i vë në thumb ata kritikë letrarë që merren tepër me analiza të veprave letrare, sepse ata, siç thotë ai, më tepër e përndajnë tërësinë sesa mund ta shprehin atë. Esencën e veprës, sidomos tërësinë e saj artistike, mund ta kuptojë vetëm poeti ose ndonjë njeri me shije të stërholluar artistike dhe ai mund ta shijojë në masën e duhur atë vlerë.<sup>16</sup>

Duke bërë fjalë për lirikën dhe për disa nga cilësitë e saj Poradeci thekson: „Esenca e poezisë lirike është muzika shpirtërore — dhe muzikën shpirtërore e bën toni shpirtëror, dhe tonin shpirtëror e bën drithma shpirtërore, lëkundja, tronditja shpirtërore — kurse tronditjen shpirtërore, domethënë, me një fjalë neologjie, *emocióni* (nënvizimi i poetit — A.B.) shpirtëror e bën as më shumë as më pak përveç se *frymëzimi* (nënvizimi i poetit — A. B.) i brëndshëm poetik i cili duket dhe ndjehet dhe kuptohet prej vetiu dhe drejt-përdrejt në transfigurimin emocional të idesë ose ndjenjës ose pamjes aktuale të poetit”.<sup>17</sup>

Mirëpo, mendimi të cilin po e citojmë në vijim jep të kuptojmë disa nga esencat e procesit të përkimeve poetike të poezisë gojore dhe të poezisë së L. Poradecit, të qëndrimit të tij ndaj traditës, ndaj poezisë së mirëfilltë artistike, ndaj poezisë moderne. Ai thotë:

„Le të themi tashi se poeti në fjalë, se akcili poet, e pat gjetur „magjinë dhembëse” të tij, si shprehje estetike, ndër ROMANTIKËT e lashtënuar. Eh, ç’ farë pastaj? Këtu lind vetvetiu pyetja, që disa, natyrisht „eruditët”, e konsiderojnë të kokllavitur, por që të tjerët — TË VETMIT QË DREJTËSOHEN (JUSTIFIKOHEN) TË FLASIN PËR TË sepse gjithnjë me anën e VEPRËS së tyre dhe jo PËRMES fjalëshumësisë së „kërkimeve” të një eruditërije pedanteske — e kanë konsideruar si të SGIDHUR VETVETIU: artisti i vërtetë s’pyet, QË KU e nxjerr lëndën brute të krijimeve të tija; ay pyet: A ka realizuar, prej asaj lënde brute, një vepër ORIGJINALE TË RE, TË FUKISHME, PLOT EKSPRESIVITET VETIJAK? „Imitimi” — relevojnë „eruditët”!; KRIJIM I RI — RELEVON poeti! Kështu them unë. Krijimi i ri, prej lëndës së vjetër... Asnjë, nga gjithë veprat artistike me jetë të përbotëshme, s’është „origjinale”; trupi i tyre është i „huaj”; vetëm SHPIRTIN, them unë, s’i-a-u disputon dot njeri. As njeri, them unë, as perëndi. Njeriu, them unë, ËSHTË MË pak se

<sup>16</sup> Sipas M. Raifit, *pun. cit.* f. 3.

<sup>17</sup> *Po aty*, f. 3.

perëndija MË SHUMË se njeriu, po shpirti LITH njeriun me perëndinë dyke valuar madhërisht midis dyve: ja! KY është, them unë, SHPIRTI i veprave artistike të vërteta, QËNIA METAFIZIKE e artistit RI-KRIJONJËS, e TRETUR në VEPRËN-RIKRIJONJËSE të tij!"<sup>18</sup>

Çështjet që duhet veçuar në këtë mendim janë para së gjithash rëndësia e jashtëzakonshme që i jep Poradeci fjalës si „magji e dhembjes” dhe qëndrimin të krijuesit të asaj lënde bruto. Sidomos vlerë të veçantë ka mendimi „Krijimi i ri, prej lëndës së vjetër...” që lidhet drejtpërdrejt me procesin e përkimeve dhe të qëndrimit të autorit ndaj traditës, qoftë asaj të shkruar, qoftë asaj gojore. Pra, Poradeci ishte i vetëdijshëm se asgjë nuk mund të jetë e vlefshme dhe e re pa pasur si bazë dhe pa u nisur nga ajo që është krijuar më parë. Mirëpo ai, po ashtu, ishte i bindur, duke pasur parasysh mundësinë e jashtëzakonshme shprehëse të fjalës poetike, se sa mund të jetë krijimi origjinal, kur poeti fut në të shpirtin krijues botën e vet që ndryshon prej botës së tjetrit, ndjesitë e veta që do të formësohen nëpërmjet sistemit të veçantë të të shprehurit, të të folurit poetik — si akt i veçantë i individualitetit krijues. Origjinaliteti i krijuesit, shpirti i veprës artistike, shprehet, pra, në aftësinë e tij rikrijuese, të themi me fjalët e poetit, kur qenia metafizike e artistit ri-krijues, tretet në veprën artistike rikrijuese. Nga kjo del se në procesin e krijimit të veprës artistike ekzistojnë mundësi të pakufishme të verifikimit të origjinalitetit nga shumë rrafshet e aspekte. Këtë gjë e shkakton sidomos fuqia magjike e fjalëve, përkatësisht e gjuhës poetike, nga struktura e së cilës dalin gjithnjë kuptime e domethënie të shumta e të pakufishme, që bëjnë efekte artistike e natyrisht edhe estetike, si qëllim parësor i veprës letrare.

Shumë cilësi të magjisë së fjalës poetike Poradeci i kishte hetuar në poezinë gojore, që e njihte mirë. Duhej vetëm që mbi bazën e saj të transponohen e të theksohen probleme e fenomene që i përkasin kohës, botës subjektive të poetit, në to të futet shpirti i kohës dhe i krijuesit, siç do të thoshte ai vetë. Krahas gjuhës poetike, si element kryesor i poezisë gojore, ai merr edhe ritmin dhe ritmikën, frymën që lidhet me vetë procesin e këndimit dhe tekstit i jep një dimension të caktuar; aktivizon shumë fjalë që ishin harruar dhe braktisur, pra nuk përdoren në shkrime, dhe i funksionalizon në sistemin e vetë krijues konceptual e shprehës.

### Çështje të modelit dhe të variantitetit

Kontakti i drejtpërdrejtë i Paradecit me poezinë gojore, e cila në vendlindjen e poetit, në rrethinë dhe më gjerë ishte shumë e pasur, ndikoi që ai të mësojë shumë prej saj, sidomos t'i shfrytëzojë

<sup>18</sup> Lasgush Poradeci, *Poezi, et coetera*, në: *Kritika letrare*, e cit. f. 417.

vlerat poetike të asaj gjuhe, e cila nëpërmjet këngës, zërit të këngëtarëve e këngëtareve, vërtet bëhej magjike dhe bënte ndikim të shumëfishtë.

Në lirikën gojore Poradeci mësoi mundësinë e pakufishme të kombinimit të gjuhës poetike, forcën e saj shprehëse e kuptimore, hetoi sistemin e formuar dhe të ngritur poetik, një refleksion e lirisëm të thellë që cilësohet me një dinamikë e harmoni mjaft karakteristike, një ritmikë të rrallë e një muzikalitet që del nga struktura tekstore, nga vargjet, nga sintagmat poetike e nga njësitë e tjera më të vogla të krijimit poetik. Në të vërtetë mu struktura e tekstit poetik të poezisë gojore, raporti ndërmjet pjesëve tekstore, vargjeve, vargut dhe njësisë më të vogla, kuptimësitë që krijoheshin dhe ritmika që krijohej nëpërmjet gjuhës poetike, i hapën një horizont Poradecit dhe ishin dëshmia më e fortë për mundësinë e jashtëzakonshme të kombinimit të fjalëve, për intensifikimin e dinamikës, të muzikalitetit, për kuptimësi të reja, si pasojë e fjalëve poetike që përdoren në një krijim dhe të raportit që krijohet midis tyre. Një qëndrim i këtillë e shtyri Poradecin ta studiojë mirë gjuhën e kësaj poezie që bartej gojë me gojë, por edhe të poezisë së shkruar shqipe të krijuar para tij dhe të bashkëkohanikëve. Ai hulumtoi leksikun, shprehjet e ndryshme, që i japin nuancim të veçantë krijimit poetik. I riaktualizoi shumë sosh, por edhe krijoi shumë të tjera mbi bazën e tyre, duke i funksionalizuar në tekstin e krijimit të vet, si rezultat i botës së tij kreative dhe i kohës së tij. Në kuadrin e strukturës tekstore gjuha poetike e Poradecit, pra sistemi shprehës, nuancohet dhe pasurohet shprehimisht (për nga shprehja) dhe kuptimisht. Vargu i tij del si rezultat i një pune sistematike, por edhe i një shpirti-liriku të ndjeshëm. Përkushtimin e tij në përpunimin e gjuhës poetike, të tekstit dhe të poezisë si krijim tërësor, si unitet strukturash e kuptimësish, e dëshmon dhe fenomeni i varianteve. Nëpërmjet varianteve të një poezie, të një subjekti artistik, ai verifikon mundësitë e pakufishme të kombinimeve të fjalëve, gjë që reflektohet jo vetëm në ndryshimin e strukturës sintaksore, por sidomos në atë artistike e kuptimore. Variantet e shumta që bënte ai, derisa një poezi merrte formën, të thuash, përfundimtare, si krijim individual, dëshmojnë se sa ndryshime mund të bëhen në planin shprehës — artistik dhe kuptimor me një leksik, të thuash, të njëjtë, duke krijuar raporte specifike të fjalëve, sintagmave, shprehjeve, vargjeve e pjesëve më të mëdha. Lasgushi ka shfrytëzuar sidomos ato fjalë që përdoren shumë shpesh në poezinë gojore, poezi e cila krijohet për t'u kënduar dhe vetëm gjatë ekzekutimit manifeston gjithë madhësinë dhe specifikën e saj, pra, fjalë që cilësohen me një muzikalitet më të theksuar si dhe me gjerësi e thellësi kuptimi.

Fenomeni i variantitetit në poezinë e Poradecit nuk është i rastit, por veçori karakteristike e sistemit të tij krijues. Disa vjersha, siç na informojnë bashkëkohanikët e tij, ai i botoi në disa variante. Ka ndodhur që një motiv ose një subjekt artistik ta përpunojë prej

10 deri në 20 variante.<sup>19</sup> Rreth këtij parimi krijues të Poradecit Mitrush Kuteli jep edhe këtë të dhënë: vetëm variantet e poezisë kushtuar Naim Frashërit përbëjnë një libër të tërë.<sup>20</sup>

Ku i kishte rrëniat një parim i këtillë krijues e Poradecit?

Mendimet mund të jenë të shumta, por këtu po i veçojmë vetëm dy çështje:

E para lidhet me faktin që e përmendëm: Poradeci donte të dëshmojë për mundësitë e pakufishme shprehëse të fjalës poetike, të një kombinatorike të pafund brenda hartimit të poezisë, ngritjes së sistemit poetik shprehës e kuptimor, pra të strukturës së tekstit artistik, të krijimit artistik si tërësi. Poeti ishte i vetëdijshëm se nga struktura e gjuhës poetike kushtëzoheshin edhe struktura e mesazhit artistik edhe mundësia e ndikimit estetik të krijimit letrar.

E dyta lidhet me konceptin e variantitetit në poezinë gojore. Poradeci duke e studiuar mirë poezinë gojore kishte njohur edhe këtë fenomen, i cili përbën një rëndësi ndërkohësi kryesore të poezisë gojore e të krijimtarisë gojore në përgjithësi. Themi kështu, sepse nëpërmjet variantitetit del në shesh aftësia e krijuesve gojorë, origjinaliteti i tyre mundësia e madhe shprehëse e kombinuese, edhe pse brenda për brenda modelit paraprak dhe sistemit që e imponon përcjellja gojore (të mbajturit mend dhe nevoja e transmetimit). Duke dëgjuar ose duke lexuar variantet e shumta të një motivi të këngëve popullore, Poradeci kishte hetuar se secili variant mbante në vete, pos elementeve të përbashkëta, edhe diçka specifike, që lidhej drejtpërdrejt me strukturën e krijimit si rezultat i gjuhës poetike dhe i kombinimeve të fjalëve dhe i raporteve që krijoheshin në disa rrafshet e shtresa: duke filluar nga ato fonologjike, leksikore, tekstore, metrike, ritmike etj. Ky fenomen ishte i pranishëm thuajse në të gjitha llojet e poezisë gojore sidomos në këngët e dashurisë, të dasmës, prataj në balada etj. Këtu po theksojmë vetëm se balada me motiv të rinjohjes motër-vëlla ndër ne ekziston në më se 80 variante, të cilat duke i vështruar nga aspekti i strukturës tekstore, pra të mesazhit artistik, aq sa përkrijnë njëra me tjetrën, po aq ndryshojnë sidomos në planin e realizimit të mikrostrukturës.<sup>21</sup>

Kur e vështrojmë fenomenin e variantitetit në poezinë e Poradecit, nuk mund të mos përmendim faktin se Poradeci nisej nga modeli paraprak krijues, të cilin e studionte mirë dhe mbi bazën e tij krijonte modelin e ri, sidomos nga aspekti i strukturës tekstore dhe shprehëse. Pra brenda modelit ekzistues dhe gjuhës poetike, që përmbajtëson modelin, Poradeci përherë përfshiu një dimension të origjinalitetit krijues, që, shikuar objektivisht, bëhet i papërsëritshëm. Me fjalë të tjera, ai përherë e tejkalon modelin paraprak, e transformon në masë të ndjeshme dhe krijon modelin, që i përgjigjet konceptit të tij krijues, si dëshmi origjinaliteti, dhe që mund t'i shër-

<sup>19</sup> Mitrush Kuteli, *pun. i cit. në: Kritika letrare, e cit. f. 342.*

<sup>20</sup> *Po aty, f. 342.*

<sup>21</sup> Qemal Haxhihasani, *Balada e rinjohjes motër-vëlla dhe lidhjet e saj ballkanike*, Studime filologjike nr. 3, Tiranë 1973.

bejë tjetrit për ta pasuruar e nuancuar edhe mëtej, varësisht nga fuqit dhe begatia e botës së tij krijuese.

### Gërshetime e përkime të strukturës së tekstit poetik dhe të ritmikës

Duke e parë poezinë e Poradecit në këtë rrafsh dhe nga aspektet që u zunë ngojë, mund të themi se e gjithë krijimtaria e tij ka lidhje të fortë me poezinë gojore shqipe, pra edhe ato poezi që janë konsideruar të errëta e mistike, siç janë *Gjeniu i anijes*, *Lundra dhe flamuri*, *Vrapojnë zemrat* etj.

Është e vërtetë se këto poezi të Poradecit nga aspekti tematiko-motivor, sikur u theksua edhe më parë, largohen nga poezia gojore, mirëpo gëshetimet dhe përkimet vërehen brenda gjuhës poetike e të sistemit shprehës, të forcës ndikuese estetike dhe të përbërësve të tjerë të krijimit letrar artistik. Në poezinë e vet Poradeci ka futur dhe frymën karakteristike të lirizmit të poezisë gojore, të ritmit dhe të ritmikës, të intonacionit etj., pra të elementeve që para së gjithash e cilësojnë këngën.

Shumë nga cilësitë e përmenduara janë elemente përbërëse të poezive të tij, natyrisht në disa kanë funksion më dominues, më funksional, e në disa më të pakët, që është gjë krejtë e zakonshme kur kihet parasysh qëndrimi dhe parimi krijues i Poradecit: ta përpunojë deri në detaje çdo element konstituiv të poezisë, duke ia nënshtruar konceptit vetjak krijues që esencialisht del mjaft koherent.

Në vijim nëpërmjet disa shembujve, po i materializojmë disa nga mendimet e shfaqura deri më tash për përkimet dhe gërshetimet e lirikës së Poradecit dhe të poezisë gojore shqipe. Krahasimi që po bëjmë me disa vargje të atyre poezive të Poradecit që edhe për nga tematika, edhe për nga struktura tekstore poetike janë të ngjashme nuk është gjë e rastit. Përkundrazi nëpërmjet këtij krahasimi esencialisht vihet në pah fenomeni i interferencës poetike në grupin e parë të poezive, ku edhe tematikisht ato afrohen me poezinë gojore, ndërsa krahasimi me tekstin e poezive që afrohen nga aspekti i strukturës së tekstit poetik, i mesazhit artistik, dëshmon për bazën e njëjtë të sistemit gjuhësor shprehës, për ritmikën e për elemente të tjera të rëndësishme për krijimin letrar artistik.

Poezitë e Poradecit siç janë, *Bjenë telat* (Rapsodi), *Ç' u mbush mali* (Rapsodi popullore), *Baladë* (Në frymën popullore), *Ku qajnë motrat vëllanë* (Vaji në kadencë, popullore), *Në porta nga mulliri*, *Po qan vasha në shtëpi*, *Vallja e luleve* etj. nga vetë titujt dhe nga të dhënat që jep poeti, para së gjithash nga modeli metriko-sintaktik dhe nga elementet e tjera të krijimit artistik si ritmi, intonacioni, muzikaliteti i vargut, fryma e përgjithshme që e cilëson poezinë lirike gojore, dëshmojnë për fenomenin e ndjeshëm të interferencës, gjë që është vërejtur dhe trajtuar nga studiues të mëparshëm.

T'i vështrojmë me kujdes shembujt nga disa poezi të përmendura, ku edhe përkimet tematike janë të ndjeshme me poezinë gojore.

## Shembulli A

*Ç u hap qjelli pak-nga-pak,  
Maj' e malit seç u flak,  
Doli ylli me bajrak:  
Me armikun kemi gjak.<sup>22</sup>*

(Ç'u mbush mali)

Shembulli A<sub>1</sub>

*Dh'atëherë... nënë mal...  
Nisi kënga me-nga-dal...;  
Nisi këng' e shentërruar,*

*E j-a mori më të shtruar...;  
e j-a drodhi më të qarë...  
E j-a zjeu .. j-a hoqi zvarë...; —*

*E pastaj si më s'u ndje,  
Zu të ngrihet që përdhé  
Gjith më nge... e gjith më nge...;  
Pasi shkoj e zë më s'kishte  
E pastaj filloj të ritet...  
E të ngritet... e të ngritet...  
Më më sulm... e më me jetë...  
Më përpjetë... e më përpjetë...<sup>23</sup>*

(Bjenë telat)

Shembujt e tjerë po i sjellim nga ato poezi të Poradecit që asnjëherë nuk janë përmendur për përkime poetike me poezinë gojore. Në këto poezi poeti trajton tema që kanë të bëjnë me përjetësinë, me filozofinë e jetës, me vdekjen, me reminishenca e ekzaltime, me përsiatje metafizike etj., që nuk i ndeshim në poezinë gojore. Mirëpo ky grup poezish, siç theksuam edhe më parë, lidhet dhe përkon me poezinë gojore, me sistemin gjuhësor-shprehës, strukturën e mesazhit artistik, ritmin, muzikalitetin që krijohet në vargje dhe në gjithë poezinë. T'i vështrojmë me kujdes.

<sup>22</sup> Lasgush Poradeci, *Vdekja e Nositit*, Prishtinë 1979, f. 95.

<sup>23</sup> *Po aty*, f. 92.

## Shembulli B

*Që larg po vi..., që larg.  
Më turren valët varg-e-varg,  
Un' ik dh'hepohen mund si harg...*

*E si më mbyt i tmershmi det.*

*Pushon ah! zemra buçet,  
Mbaron ah! zjarri që më tret.<sup>24</sup>*

(Lundra dhe flamuri)

Shembulli B<sub>1</sub>

*Pa nis ah! gjirin t'a godas...  
Dh'e hap ah! — gjirin më një ças...,  
Dh'i nginj ah! zoqtë-e vdes me gas!...*

*Ay e tund, ay e shkund,  
Ay e hap sa me të mund,  
Gjer mun në gjit, gjer mun në fund.<sup>25</sup>*

## Shembulli C

*Dhe ik...e ik...e ik...e ik...  
E ja! këputet zemr' e shkretë.  
E ja! përshembet vrap' i lik  
E bje përmbys përgjithëjetë.<sup>26</sup>*

(Vrapojnë zemërat)

Nëse midis shembullit A dhe B dhe A<sub>1</sub> dhe B<sub>1</sub> si dhe A<sub>1</sub>, B<sub>1</sub> dhe C bëjmë krahasime nga aspekti i strukturës gjuhësore poetike, i ritmit dhe i tonalitetit ritmik, atëherë gjasimet janë të dukshme në disa rrafshë.

Grupi i parë i shembujve A dhe A<sub>1</sub>, që i përkasin poezive lirike të Poradecit, ku ndikimi i poezisë lirike gojore është më i ndjeshëm (edhe tematik e motivor), ka shumëçka të përbashkët me grupin e dytë (B, B<sub>1</sub> dhe C) të poezive të cilat tematikisht largohen nga poezia gojore.

<sup>24</sup> *Po aty*, f. 203. (Shih përkthimin shumë të qëlluar të disa poezive të L. Poradecit në gjuhën serbokroate nga Mensur Raifi, në: *Oko*, Zagreb 1978, 21 rujna — 5 listopada).

<sup>25</sup> L. Poradeci, *Vdekja e Nositit*, e cit. f. 205.

<sup>26</sup> *Po aty*, f. 208.

Pas krahasimit dhe studimit të teksteve poetike të shembujve (dhe të poezive) të përmendura nxjerrim këtë përfundim:

Nëse grupi i parë i poezive të Lasgush Poradecit në mënyrë të ndjeshme është i lidhur me gjuhën poetike dhe me strukturën metrike-sintaksore të poezisë gojore, atëherë grupi i parë i poezive të Lasgushit është i lidhur ngushtë me grupin e dytë të poezive të tij. Nga kjo mund të përfundohet se edhe grupi i dytë, përkatësisht poezia e tij refleksive, filozofike dhe ajo me tematikë mbi vdekjen, reminishencat dhe konceptet metafizike etj. lidhet me poezinë gojore. Kjo lidhje ngjet nga shkaku i strukturës së gjuhës poetike, i sistemit shprehës dhe i ritmit e muzikalitetit të vargut, që e cilësojnë tekstin e kënduar të krijimit gojor.

Po sjellim edhe dy shembuj nga poezi të tjera për të dëshmuar se përkimet poetike të poezisë së Poradecit me poezinë gojore janë të dukshme.

Të parin po e marrin nga poezia *Ndjenja dhe njeriu*, ku poeti nëpërmjet dialogut midis ndjenjës dhe njeriut shqipton një problem ekzistencial: raportin ndërmjet dashurisë, gjakimit, pësimit, mundësisë dhe vuajtjes. Poezia ka një dinamikë të brendshme dhe është ndërtuar mbi bazën e dialogut të krijimeve gojore, të strukturës së tij gjuhësore-shprehëse.

*Pa e pyet dhe vet' e ti*

*Të mosbindurin njeri,  
Dhe për zemrën që j-u thye  
I kërkoj një arësye;  
Ç'ke që vuan, o njeri?  
Ç'ke që bret me dhembshuri?  
Ç'ke që djek posi qiri?  
(...)*

*Po njeriu ndaj e dëgjonte,  
Hapte gojë e kuvendonte —  
Kuvendonte më të qarë,  
Me zembrim, me shpirt të vvarë.<sup>27</sup>*

Shembullin e dytë po e sjellim nga poezia *Përjetësia*, e cila me të drejtë konsiderohet ligjëratë poetike për përjetësinë. Në këtë krijim Poradeci hulumton dhe shqipton totalitetin njohës të krijimtarisë nga aspekti filozofik si dhe bën përpjekje ta definojë qenien krijuese. Gjithë këtë e realizon në relacionin: UNË JETA. Edhe pse tematika e kësaj poezie nuk ka të bëjë me krijimtarinë gojore e as me poezinë gojore, struktura poetike dhe vargësore për shumëçka na kujton atë të krijimeve gojore në poezi.

<sup>27</sup> *Po aty*, f. 188.

*Dhe hapa shteg-bashkimi nëpër trup:  
Atë të gojës, plot margaritar,  
Atë të dorës, ndritur si zambak,  
Atë të hundës, drejt posi qiri.<sup>28</sup>*

Elemente të përkimeve poetike ndeshim edhe në lirikën e dasharisë së Poradecit. Edhe në krijimin e poezive me tematikë të këntillë poeti nisët nga konceptioni estetik i krijimit gojor letrar, nga mundësia e ndikimit të tij sa më të madh në marrësin, pra, ka parasysh kategorinë estetike kolektive. Natyrisht edhe në këto poezi ai përfshin të gjitha ato elemente që i përmendëm gjatë shqyrtimit të poezive refleksive, filozofike etj.

Nga gjithë ajo që u tha dhe u shqyrtua deri më tash, sidomos nga shembujt e sjellë, del se fenomeni i përkimeve poetike të poezisë gojore shqipe në poezinë e Lasgush Poradecit jo vetëm është i pranishëm, por manifestohet në disa rrafshe e në disa aspekte, sidomos lidhjet e forta kushtëzohen nga gjuha poetike dhe sistemi shprehës si dhe nga ritmi, muzikaliteti i vargut etj. Megjithatë, lidhjet e shumëfishta dhe përkimet gjuhësore poetike të gjithë poezisë së L. Poradecit me poezinë gojore nuk e zvogëlojnë origjinalitetin e këtij poeti, përkundrazi dëshmojnë për faktin se ku mbështetëj ai dhe sa arriti të krijojë një sistem origjinal, ta ngrejë në një nivel të lartë poezinë shqipe në përgjithësi dhe t'i dhurojë asaj disa nga krijimet më moderne dhe artistikisht më të realizuara.

Duke e parë problemin e përkimeve poetike në këtë mënyrë dhe duke i kushtuar kujdes sidomos gjuhës poetike dhe aktit konkret krijues të hartimit të poezisë, si njërit ndër elementet më qenësore, pjesërisht kemi dhënë përgjigje, përkatësisht deri diku i kemi materializuar mendimet e E. Çabejt dhe të M. Kutelit cituar në fillim se Poradeci është poeti që përdor një gjuhë magjike dhe se është poet shqiptar që shkruan, flet dhe mendon vetëm shqip.

*Anton Berisha*

LES CONCORDANCES POÉTIQUES DE LA POÉSIE ORALE  
ET DE LA CRÉATION POÉTIQUE DE LASGUSH PORADÉC

R é s u m é

Dans le cadre des concordances poétiques de la poésie orale albanaise et de la poésie écrite la création poétique de Lasgush Poradec mérite une analyse et une interprétation spéciale, non seulement afin de noter l'influ-

<sup>28</sup> *Po aty*, f. 194.

ence, la proximité et la combinaison, voir l'imbrication de la poésie orale dans la poésie de cet écrivain, mais aussi afin de souligner quelques types et de dégager l'essence même de la création poétique de cet auteur. Nous nous exprimons ainsi tout en sachant que la poésie lyrique de Poradec est essentiellement une poésie moderne dont la valeur artistique est indéniable. Les thèmes de ses poèmes sont souvent différents de ceux qu'on rencontre dans la poésie orale albanaise; cependant la poésie s'appuie fortement sur celle poésie lyrique; ceci vaut non seulement pour une partie de sa poésie comme on l'a souvent mentionné, mais pour toute sa création poétique.

Le contact direct qu'eut Lasgush Poradec avec la poésie orale de son lieu de naissance (Poradec) ainsi que les diverses publications de poésie orale albanaise, qui à l'époque où le poète débutait dans la poésie étaient nombreuses et de qualité, influèrent visiblement sur les concordances de la poésie orale et de sa création poétique. Parallèlement à cela, l'écrivain lut aussi les écrits des plus grands poètes de son temps et découvrit les fondements de la poésie et la source de leur popularité. Grâce à cela il apprit à estimer la valeur de la poésie orale albanaise, surtout de son langage poétique qui, par l'intermédiaire des chants populaires exprimait avec une force extraordinaire l'influence esthétique multiple.

Poradec s'appuya sur la poésie lyrique orale et utilisa les possibilités infinies de combinaison du langage poétique, sa force d'expression et sa richesse sémantique, le système développé et élève de la formation poétique, le reflet d'un profond lyrisme qui est contenu dans le rythme, le mouvement et l'harmonie caractéristique. En effet, la structure du texte poétique de la poésie orale, le rapport entre les parties du texte, les vers, les syntagmes poétiques et les unités plus petites témoignaient de la possibilité extraordinaire de combinaison des mots, de l'augmentation du sens, de l'accroissement du mouvement et de la musicalité ect. qui sont conditionnés par la formation de la création dans son ensemble. Ceci se concrétise par le phénomène des variantes de l'objet artistique de sa poésie, à cette occasion Poradec crée seulement autour d'un motif 10 à 20 variantes parfois davantage comme c'est le cas pour la poésie consacrée à Naim Frashëri.

Pour concrétiser le phénomène des concordances poétiques dans toute la poésie de L. Poradec nous avons comparé les poésies — dont les thèmes, la langue poétique et le système d'expression artistique ont un rapport étroit avec la poésie orale pour laquelle on a souvent écrit; des comparaisons ont été faites, les éléments semblables ont été soulignés ainsi que l'influence sensible de la poésie orale sur ces poésies — avec les autres poésies qui diffèrent de par leurs thèmes des créations poétiques orales, mais qui ont des correspondances et se rencontrent en de nombreux points et domaines, au point de vue linguistique expressif et de la structure du message artistique. En comparant et en soulignant les éléments semblables dans les deux groupes de poésie de Poradec, surtout ceux concernant l'aspect du langage poétique, la structure du rythme, la rythmique et la musicalité du vers qui est liée au chant ect. nous avons, en fait, mis en évidence le phénomène des concordances dans toute la poésie de Poradec.

L'analyse comparative des deux groupes de poésie de Lasgush Poradec du point de vue du langage poétique et de la structure du message artisti-

que nous a permis d'apporter une réponse et de faire notre les réflexions d'E. Çabej sur Poradec, à savoir qu'il utilise une langue magique, et de Mitrush Kuteli, pour qui Poradec est le poète albanais qui écrit, parle et pense seulement en albanais. Cette approche et cette analyse ont pour but de souligner et d'analyser en détails quelques caractéristiques et éléments essentiels de la poésie de L. Poradec et naturellement de mettre en évidence le fondement de sa création poétique, précisément les rapports et les concordances manifestes avec la langue poétique et la structure du message artistique de la poésie orale albanaise et de la catégorie esthétique collective comme éléments très importants pour la création littéraire orale.